



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

---

AD/GjKK.nr.4/23

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** – Autoriteti Kompetent - Kryetari Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga E.H. – për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale – H.K., me pretendimin për shkelje ligjore, fyerje dhe shpifje, bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 19.09.2023 merr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga E.H., ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale - H.K., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate (*tutje Autoriteti Kompetent*), më 13.09.2023 përmes postës elektronike (*email zyrtar*), ka pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në kompetencë ankesën e paraqitur më 11.09.2023 nga E.H., për shqyrtim dhe vendosje lidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e cila përcakton se personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtar lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek Autoriteti Kompetent, ndërsa në pika 1.1, e të njëjtit paragraf përcakton se: “*Autoritetit Kompetent në këtë rast është Kryetari i Gjykatës Themelore në të cilën shërben gjyqtari, për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të atij gjyqtarit*” dhe 1.2 “*Kryetari i*

*Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryetarit të Gjykatës se Apelit”.*

Në ankesën për inicim të procedurës disiplinore parashtruesi E.H., pretendon se gjyqtari H.K. si komshi i tij ka bërë shkelje ligjore me rastin e ndërtimit të shtëpisë së tij private, si dhe fyerje dhe shpifje ndaj tij në polic: *“H.K. i cili njëherit është gjyqtar në Gjykatat e Republikës së Kosovës,, gjithashtu edhe komshi i imi në Prishtinë, ka bërë shkelje ligjore në ndërtimin e shtëpisë së tij ku banon, pasi që nuk iu ka përmbajtur rregullave komunale për hapjen e dritareve, pasi që i ka hapur dritaret e shtëpisë së tij, nga ana e oborrit tim, me ç’rast po më pengon mua për të qëndruar lirshëm në oborr”,* thuhet në ankesë.

Në ankesën e parashtruar, po ashtu është theksuar se tek gjyqtari K., i njëjti ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me këtë çështje, por sipas pretendimeve të ankuesit i njëjti e ka ofenduar, ka bërë shpifje në polici dhe ka treguar sjellje jo njerëzor dhe jo etike.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës, më datë 13.09.2023 bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka kërkuar nga gjyqtari H.K. deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore.

Më 18.09.2023, gjyqtari H.K. në deklaratën e tij dhënë me shkrim, lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën për inicimin e procedurës disiplinore, ka deklaruar se parashtruesi i ankesës E.H. përmes mesazheve telefonike – sms, ka filluar kanosjet ndaj tij gjatë muajit korrik të këtij viti. Lidhur me kanosjet rastin e ka paraqitur në Policinë e Kosovës dhe e njëjta është e evidentuar sipas numrit 2023-AB-1806 të datë 11.07.2023.

*“Pas disa javësh, përkatësisht me datën 06.08.2023, jam kontaktuar nga ana e Policisë së Kosovës dhe më kanë informuar se e kanë ndaluar të dyshuarin/personin e lartcekur dhe i njëjti sipas deklaratimit të zyrtarit policor ka shprehur keqardhje dhe pendim për kanosjet ndaj meje duke u arsyetuar se të njëjtat i ka bërë nën efekt dhe se nuk do të i përsërit veprimet e tilla në të ardhmen. Mirëpo i njëjti person me datën 08.09.2023 rreth orës 01:30 pas mesnate ka filluar përsëri me sharje dhe ofendime dhe kërcënime serioze ndaj meje dhe motrës time E.K.. Lidhur me këto kërcënime serioze të këtij personi, unë menjëherë e kam lajmëruar Policinë e Kosovës përmes telefonit, si dhe e kam paraqitur rastin në Policinë e Kosovës i cili rast evidentohet sipas numrit*

2023 – AB – 2393 të datë 08.09.2023. Vlen të theksohet se i njëjti person është recidivist i shumë veprave penale dhe ndaj të njëjtit janë të hapura edhe shumë raste të tjera. Po ashtu i njëjti person përveç kanosjeve dhe sharjeve ndaj meje dhe familjes time, të njëjtat veprime i ka bërë edhe ndaj fqinjëve tjerë, ku të njëjtit po ashtu i kanë paraqitur rastet në organet kompetente. I njëjti po ashtu për një rast të sulmit ndaj një fqinje ka qenë edhe në masë të paraburgimit për disa muaj”, thuhet në deklaratën e gjyqtarit.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore lidhur me shkeljet ligjore me rastin e ndërtimit të shtëpisë dhe hapjen e dritareve, gjyqtari K. ka sqaruar se pretendimet e tilla janë tërësisht të pavërteta: “Fillimisht theksoj që shtëpia në të cilën unë banoj është ndërtuar në vitin 2001, ku në periudhën kur është ndërtuar e njëjta, unë kam qenë nëntë vjeçar. Shtëpia është e ndërtuar në tri kate të ndara (tri njësi banesore), ndërsa pronare e shtëpisë ka qenë gjyshja ime e ndjerë. Pas vdekjes së gjyshes time, është bërë ndarja e trashëgimisë, ku si trashëgimtar ligjor të gjyshes sime janë nëna ime dhe dy motrat e saj, ku nënës time i ka takuar kati i dytë i shtëpisë (njësi banesore). Shtëpia në fjalë është ndërtuar sipas kushteve urbanistike të asaj kohe dhe e njëjta është e regjistruar dhe e pajisur me certifikatë pronësore. Ndërsa ankuesi nuk është pronar i oborrit dhe shtëpisë në të cilën jeton e për të cilën pretendon që po i shkelet privatësia”.

Tutje gjyqtari K., lidhur me pretendimet për sjellje jo etike dhe jo njerëzore si në ankesën e parashtruesit, ka deklaruar se: “Të njëjtat deklaramë janë të pavërteta dhe të sajura me të vetmin qëllim që të shmanget nga përgjegjësia e veprimeve të tij, duke tentuar që veprimet inkriminuese të tij, të i shfajësoj dhe të ndikoj te organet shtetërore për mos ndërmarrje të masave ndaj tij, në emër të kinse ndikimit për shkak të funksionit që unë ushtroj. Për më tepër në ankesën e tij, i njëjti as nuk ka mundur që të përmend qoftë edhe një fjalë të tillë që unë e kam përdorur ndaj tij. Është thellësisht shqetësuese dhe jo serioze mostrajtimi i kanosjeve dhe kërcënimeve të këtij personi nga organet kompetente, duke marr për bazë faktin se ndaj tij veçse i kam iniciuar dy procedura penale, ndërsa ndaj tij janë iniciuar edhe procedura tjera nga fqinjët tjerë dhe deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë veprim parandalues, për parandalimin e rrezikut që na kanoset çdo ditë. Andaj nga të lartcekurat në këtë rast vlerësoj dhe jam thellësisht i bindur se nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore nga ana ime, e për më tepër edhe nga vet përmbajtja e ankesës së personit në fjalë,

*vërehet se nuk ka asnjë bazë për inicim të procedurës disiplinore përveçse tendencës për njollosje të emrit tim dhe pozitës që unë mbaj dhe tentim për të shmangur përgjegjësitë e tij”.*

Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë dhe deklaratën e gjyqtarit, gjeti se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore është e pabazuar dhe dukshëm joserioze. *“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...”* – neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti i Gjykatës Komerciale vëren se gjyqtari H.K. dhe veprimet e tij të shënuara si më lartë, nuk ndërlidhen me pozitën e tij si gjyqtar i Gjykatës Komerciale dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si shkelje disiplinore siç pretendohet në ankesë, pasi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndër të tjera përcakton, se: *“masave disiplinore u nënshtrohen gjyqtarët dhe prokurorët për shkelje disiplinore në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligj..., dhe atëherë nëse gjyqtari dënohet për veprë penale, shkel ligjin, shkel detyrat e tij zyrtare si gjyqtar sipas ligjit..., në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë”*, në rastin konkret gjyqtari K. nuk ka qenë duke ushtruar funksionin zyrtar të gjyqtarit, aq më tepër i njëjti sipas edhe deklarimit të tij dhënë në polici me rastin e denoncimit të rastit, ka deklaruar se e gjithë kjo situatë nuk lidhet me punën e tij si gjyqtar.

Në rastin konkret dhe duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi, nuk mund të kërkohet inicim i procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në rast se nuk përmbushen kushtet e përcaktuara si më lartë, pasi autoriteti kompetent vlerëson se me veprimet e tij gjyqtari K. nuk ka shkelur procedurat gjyqësore, aktet ligjore apo Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, dhe këto veprime nuk mund të hynë në kategorinë e shkeljeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi si bazë për inicim të procedurës disiplinore.

Ndershmëria dhe moraliteti gjyqësor, padyshim që përbëjnë elementet kryesore të integritetit, dhe gjyqtari jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare por gjithmonë duhet të veprojë me ndershmëri

dhe në mënyrë të denjë për pozitën gjyqësore, siç përcaktohen edhe me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar, megjithatë në rastin konkret sipas fakteve të kësaj çështje gjyqtari K. në asnjë rast nuk ka vepruar në kundërshtim me rregullat apo dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë shkeljet e detyrës zyrtare, integritetit profesional apo moralitetit gjyqësor, pasi i njëjti si qytetar i këtij vendi ka kërkuar ndihmë dhe mbrojtje nga Policia e Kosovës, pas pranimit të kërcënimeve direkte lidhur me çështje private/personale.

Ndërsa çështjet që ndërlidhen me objektin kontestues sipas ankuesit nuk mund të bien në përgjegjësinë e gjyqtarit i cili nuk është ndërtues e as pronar i objektit dhe personalisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të vetëm me të cilin do të mund të atakonte ndonjë të drejtë ankuesit. Për më tepër çështjet e ngritura nga ankuesi mund të zgjidhën në procedura të tjera administrative apo gjyqësore ndërmjet pronarëve legjitim, por nuk ndërlidhen me gjyqtarin dhe nuk hyjnë në domenin e trajtimit disiplinor.

Ky konstatim rezulton edhe nga raporti i mediave i publikuar me datë 12.07.2023 në portalin “Sinjali.com” në të cilin jepen informata lidhur paraqitjen e rastit në polici dhe fillimin e hetimeve nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke paraqitur me këtë rast edhe pjesë nga dëshmia e gjyqtarit dhënë pranë Policisë së Kosovës, se rasti në fjalë nuk lidhet me punën e tij në Gjykatën Komerciale.

Për më tepër ky proces i natyrës disiplinore për gjyqtarin K., ka përfunduar me kallëzim penal, pranë Policisë së Kosovës më datë 11.07.2023 dhe Prokurorin e Shtetit, rrjedhimisht edhe sipas Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, në bazë të të cilit është kërkuar inicimi i procedurës disiplinore, nuk përcaktohet ekzistenca e inicimit të procedurës disiplinore kundër gjyqtarit pa u atribuuar të gjitha faktet si shkelje disiplinore, sepse sipas legjislacionit në fuqi çështja e ndërtimeve/shtëpisë në këtë rast, rregullohet sipas procedurave të veçanta nga organet përgjegjëse komunale dhe për shkeljen e këtyre rregullave vendosin po të njëjtat organe, ndërsa procedurat e tjera si kallëzimi penal i paraqitur nga gjyqtari për kanosje, si dhe kërkesa për inicim të procedurës disiplinore me pretendimin për shpifje janë procese të pavarura nga njëri tjetri, dhe të njëjtat zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave të ndryshme.

Rrjedhimisht nga faktet e konstatuara në shkresat e rastit dhe vlerësimit të deklarimeve të palëve nuk është gjetur asnjë sjellje e gjyqtarit i cili do të vinte në dyshim integritetin e tij apo sjelljen profesionale si bazë për iniciimin e procedurës disiplinore, andaj si e tillë ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti kompetent ka gjetur se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, dhe si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

AD.GJKK.nr.4/23, më datë 19.09.2023

Mahir Tutuli

---

Kryetar i Gjykatës Komerciale

Iu dërgohet:

- E.H. – Parashtruesi i kërkesës
- Albert Zogaj – Kryesues i KGjK
- Avokati i Popullit
- H.K. – Gjyqtar i Gjykatës Komerciale